

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIV, nr. 7808  
E hënë, 10 qershor 2024  
Çmimi 0.50

## Vazhdon rënia e numrit të popullsisë në Kosovë

FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# SHEFI I EULEX-it: BANJSKA E KA DËSHMUAR BRISHTËSINË E VERIUT

FAQE 4-5




Shefi i misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano, ka thënë të dielën se sulmi në Banjskë të Zveçanit e ka dëshmuar

brishtësinë dhe cenueshmërinë e veriut të Kosovës. Ai ka bërë thirrje për dhënie fund të tensioneve dhe krizave. Shefi i EULEX-it ka thënë se misioni që udhëheq e

ka rritur shkallën e vigjencës për të mos lejuar përsëritjen e ndonjë krize dhe e di që Kosova ka përforcuar praninë dhe kapacitetet e veta përgjatë kufirit

## GËRVALLA: SHQYRTIMI I DRAFTIT PËR ASOCIACIONIN, VETËM NËSE SERBIA E ZBATON MARRËVESHJEN BAZË

F.7




## PËRGJIGJJA NUK ISHTE LIBRI

F.7

Berat ARMAGEDONI



## AKTUALE



**ZELENSKY: KA DËSHTUAR OFENSIVA E RUSISË NË HARKIV** F.2

**SHKURTE FEJZA DHUROI ATMOSFERË TË ZJARRTË ME KONCERTIN E SAJ. FALEMINDERIT IKONË E MUZIKËS!** F.6

**BRENDA PESË MUAJVE 511 PRISHTINAS U KAFSHUAN NGA QENTË** F.6

## EKONOMI



**KOMUNAT AKUZOJNË QEVERINË PËR MUNGESË TË FINANCIMIT NË PROJEKTE** F.7

**TEMPERATURAT E LARTA NË KOSOVË SHQETËSOJNË BUJQIT** F.7

## SPORT



**LEGJENDA FADIL VOKRRI KUJTOHET NË 6-VJETORIN E SHKUARJES NË AMSHIM** F.14

**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mobi: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë.  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Zelensky: Ka dështuar ofensiva e Rosisë në Harkiv

KIEV, 9 QERSHOR - Ushtria ruse "ka dështuar" ta shtrijë ofensivën e vet në rajonin e Harkivit, ka thënë presidenti ukrainas Volodymyr Zelensky përmes një video-mesazhi. Pasi ka folur me komandantë ushtarakë, ai ka thënë se forcat ukrainase janë duke frenuar përparimet ruse në atë zonë dhe janë duke shkatërruar njësitet ruse që kanë hyrë dhe e kanë terrorizuar rajonin e Harkivit.

Zelensky ka thënë se kjo gjë përbën "rezultat shumë të rëndësishëm".

Më herët, gjatë 10 majit, forcat ruse kanë nisur një ofensivë në rajonin e Harkivit, përgjatë kufirit ruso-ukrainas, hap që analistët e kanë përshkruar si tentim për të krijuar "zonë neutrale" përmes së cilës mbrohet territori i Rosisë.

Për luftime të ashpra është raportuar rreth qytezës Vovçansk,

të cilën ushtria ukrainase ka thënë se e ka nën kontroll.

Më 17 maj komandanti i ushtrisë ukrainase Oleksandr Syrskiy ka thënë se Rusia e ka zgjeruar ofensivën në një vijë prej 70 kilometrash, në përpjekje për ta detyruar Ukrainën që t'i angazhojë edhe rezervistët.

Një ditë më parë, presidenti amerikan Joe Biden ka thënë prej Francës se Kremli nuk do të ndalet në Ukrainë nëse fiton.

Presidenti rus Vladimir "Putin nuk do të ndalet në Ukrainë... E gjithë Evropa është e kërcënuar. Ne nuk do të lejojmë të ndodhë diçka ashtu", ka thënë Biden. "Shtetet e Bashkuara janë duke mbështetur Ukrainën. Nuk do ta braktisim, e përsëris".

Përveç ndihmës ushtarake për Ukrainën, në vlerë të 61 miliardë dollarëve, të miratuar nga Kongresi amerikan më herët gjatë vitit,



Bideni ka paraqitur edhe një paketë tjetër në vlerë të 225 milionë dollarëve që përfshin municione, raketa, mortaja, artileri dhe raketa për mbrojtje ajrore.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24

shkurt të vitit 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" për ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndimi është përgjigjur ndaj

Rosisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra. Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtëpitë e tyre.

## Koreja e Jugut do t'i rinisë transmetimet me altoparlant përtej kufirit

SUELI, 9 QERSHOR - Koreja e Jugut ka thënë se ka rinisur përhapjen e materialeve propaganduese me altoparlant kundër Koresë së Veriut - për herë të parë pas gjashtë vjetësh - si kundërpërgjigje ndaj fushatës së Phenianit, i cili ka nisur balona të mbushura me mbeturina përtej kufirit.

Më shumë se 300 balona të mëdha janë regjistruar të



shtunën dhe të dielën në Korenë e Jugut, të mbushura me mbeturina prej letre dhe

plastike.

Koreja e Veriut nuk ka reaguar ende, mirëpo Phenani e konsiderohen përhapjen e materialeve propaganduese si akt lufte dhe ka kërcënuar në të kaluarën.

Muajin e kaluar Koreja e Veriut besohet se ka dërguar të paktën 200 balona të tilla me mbeturina drejt jugkoreanëve, si hakmarrje për fletëpalosjet

me materiale propaganduese që janë përhapur prej Koresë së Jugut.

Koreja e Jugut ka thënë se në mbeturinat nëpër balona nuk janë gjetur materiale të rrezikshme.

Në mesin e materialeve që përhapen me altoparlant në zonat kufitare përfshihen lajme prej dy rajoneve, si dhe informacione për demokracinë

dhe jetën në Korenë e Jugut. Ushtria jugkoreane pretendon se këto transmetime mund të dëgjohen deri në 10 kilometra përtej kufirit gjatë ditës dhe deri në 24 kilometra larg gjatë natës. Dy Koretë janë ndarë prej Luftës Koreane që ka përfunduar më 1953. Ato nuk kanë nënshkruar traktat të paqes, prandaj teknikisht janë në luftë qysh atëherë.

## Miliona njerëz votojnë në ditën e fundit të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian



STRASBURG, 9 QERSHOR - Banorët e 20 vendeve të Bashkimit Evropian kanë votuar të dielën, në ditën e fundit të zgjedhjeve për Parlamentin Evropian. Këto zgjedhje po konsiderohen si shumë të rëndësishme pasi kontinenti evropian po përballet me politika polarizuese dhe rritje të nacionalizmit.

Grupi më i madh i qendrës së

djathhtë në Evropë, Partia Popullore Evropiane, pritet të fitojë më së shumti vota në gjithë vendet e BE-së, ndonëse partitë e së djathtës ekstreme po synojnë sa më shumë vota në nivel kombëtar.

Marshi Kombëtar i Francës, Vëllezërit e Italisë në Itali dhe Partia e Lirisë në Austri, janë në krye të sondazheve, ashtu sikurse partia separatiste dhe kundër migrimit

në Belgjikë, Vlaams Belang. Votimet kanë nisur prej të enjtes dhe më pas janë zhvilluar nëpër disa shtete, mirëpo shumica e evropianëve kanë shfrytëzuar të drejtën e tyre të dielën.

Parlamenti Evropian lidh direkt evropianët me institucionet e Bashkimit Evropian.

Duke qenë zgjedhjet e para pas pandemisë së koronavirusit, nisjes

së luftës së Rosisë në Ukrainë, valës së imigrantëve, dhe rritjes së rreziqeve prej ndryshimeve klimatike, këto zgjedhje po konsiderohen tejet të rëndësishme për të ardhmen e Parlamentit Evropian. Kjo, gjithashtu, është herë e parë që mbahen zgjedhje të tilla pa Britaninë e Madhe, e cila është larguar zyrtarisht prej BE-së më 2020.

## Narendra Modi betohet si kryeministër i Indisë për herë të tretë

DELHI, 9 QERSHOR - Narendra Modi, lideri i partisë nacionaliste hinduse, Bharatiya Janata, është betuar si kryeministër i Indisë për herë të tretë.

Ceremonia është zhvilluar në rezidencën zyrtare të presidentit të Indisë.

Partia e Modit i ka fituar zgjedhjet e përgjithshme të Indisë, duke siguruar 293 ulëse në Parlament, por më

pak sesa ishte parashikuar nëpër sondazhe.

Në këto zgjedhje është forcuar opozita në Indi, e cila i ka fituar 234 ulëse.

Mijëra persona kanë marrë pjesë në ceremoninë e inaugurimit të Modit në Delhi.

Aty kanë shkuar edhe krerë shtetërorë prej Bangladeshit, Nepalit, Shri Lankës dhe Maldiveve.

Masat e sigurisë kanë qenë të

rrepta. Në zonën e inaugurimit kanë qenë 2 500 zyrtarë policorë.

Përgjatë ceremonisë, presidentja indiane Draupadi Murmu e ka udhëhequr edhe ceremoninë e betimit të kabinetit të Modit.

Modi i ka falënderuar votuesit për mandatin e ri dhe ka thënë se do të bëjë gjithçka për ta zhdukur korrupsionin dhe varfërinë.



## Zëdhënësja e BE-së: Dezinformatat ruse mund t'i rrisin tensionet në Kosovë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ballkani Perëndimor është duke u përballur me dezinformata prej Ruisë, përmes të cilave Moskë tenton ta pengojë integrimin e rajonit në Bashkimin Evropian. Kështu ka thënë zëdhënësja e Bashkimit Evropian në Kosovë, Ioanna Lachana, përgjatë një interviste për platformën "The Geopost". Sipas saj, Kremli po tenton të përhapë në Kosovë narrativa pro Ruisë dhe të paraqesë negativisht gjithçka që është pro Perëndimit. Diçka e tillë, sipas saj, mund t'i rrisë tensionet. "Kemi parë propagandë në lidhje me tensionet ndëretnike, që mund të shpërthejë një luftë e re. Kjo është shumë e rrezikshme. Kjo mund t'i rrisë tensionet. Prandaj Bashkimi Evropian ka thënë gjithmonë se dezinformimi është çështje që prek sigurinë". Zyrtarët më të lartë shtetërorë në Kosovë e kanë përmendur disa herë se përpjekjet e Ruisë



në Ballkan përhapen nëpërmjet "satelitit të saj, Serbisë", dhe se shteti rus tenton të përfitojë prej tensioneve në mes të Kosovës dhe Serbisë.

Beogradi i mohon vazhdimisht këto qëndrime. Lachana ka thënë se në momentin që një propagandë e tillë ruse përhapet dhe

përsëritet, mund të ketë njerëz që nisin të kenë ndjesi kundër Perëndimit. "Nëse informacioni manipulohet, atëherë preket edhe diskursi ynë publik.

Ballkani Perëndimor nuk përbën përjashtim. Ne shohim ndikim edhe këtu, sidomos prej Ruisë, e cila tenton ta pengojë rrugën e partnerëve të Ballkanit Perëndimor drejt integritimit në Bashkimin Evropian. Natyrisht, askush nuk mund të luftojë vetëm këtë fenomen. Duhet të punojmë bashkë dhe të përfshihen të gjithë". Lachana e ka përmendur edhe strategjinë e re të Shteteve të Bashkuara për ta luftuar dezinformimin në Evropë, sidomos në Ballkan, e cila përfshin mbështetjen e demokracive, medieve të lira dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Muaj më parë agjencitë franceze të sigurisë patën zbuluar rrjetin e ashtuquajtur "Portal Kombet" prej 193 faqeve online, që ka përhapur dezinformata me qëllim të përçarjes së shoqërive perëndimore.

## Gërvalla: Shqyrtimi i draftit për Asociacionin, vetëm nëse Serbia e zbaton marrëveshjen bazë

Prishtinë, 9 qershor - Ministria e Punëve të Jashtme dhe e Diasporës e Kosovës, Donika Gërvalla, ka thënë se Kosova do të mund ta shqyrtojë draft-statutin e propozuar nga Perëndimi për krijimin të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe vetëm nëse ai dokument është pjesë e marrëveshjes bazë për normalizim marrëdhëniesh, të arritur në mes të Kosovës dhe Serbisë, një vit më parë, dhe nëse atë e respekton Beogradi. "Ka një logjikë pse duhet të jetë pjesë e pakos, sepse pakoja parasheh njohjen de facto nga ana e Serbisë. Një dokument i tillë nuk është i shëndoshë për vendin tonë në momentin që nuk e kemi as njohjen de facto, e lëre më njohjen de juro nga ana e Serbisë". Ajo i ka bërë këto deklarata në një intervistë për agjencinë e lajmeve KosovaPress. Sipas Gërvallës, aktualisht Qeveria e Kosovës nuk mund të procedojë draftin për Asociacionin pasi, sipas saj, draftet nuk dërgohen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese. "Draftet duhet të kalojnë nëpër disa etapa para se të dërgohen në Gjykatën Kushtetuese. Dhe ky draft, kështu siç është, i shkëputur nga pakoja që kemi në Bruksel, nuk mund të procedohet më tej nga qeveria në asnjë hap", ka thënë Gërvalla. Ajo ka thënë se ky draft është pjesë e marrëveshjes bazë, të cilin Kosova se ka në plan ta shkëpusë. "Çfarë kemi thënë ne, u kemi propozuar partnerëve tanë që nëse ata konsiderojnë që me Serbinë nuk mund të arrijmë sukses në formë bilaterale, atëherë ne si qeveri e përgjegjshme kemi treguar




gatishmërinë tonë që të ulemi edhe me përfaqësues të serbëve në Kosovë, të hartojmë një dokument që respekton rendin tonë kushtetues, ligjet tona, por edhe plotëson disa kërkesa të komunitetit serb në Kosovë. Për këtë propozim ende nuk kemi hasur në gatishmërinë e partnerëve tanë". Faktori ndërkombëtar insiston që Kosova duhet të formojë sa më shpejt Asociacionin e Komunave me Shumicë Serbe. Mosbërja e hapave në këtë drejtim e ka penalizuar Kosovën me mosanarësim në Këshillin e Evropës - organizatën lidere për të drejta të njeriut - më herët gjatë këtij viti. Kosova dhe Serbia kanë arritur marrëveshje për Asociacionin më 2013 dhe më pas më 2015 mbi parimet për themelimin e tij. Po më 2015, Gjykata Kushtetuese e

Kosovës ka gjetur se marrëveshja nuk është në harmoni të plotë me Kushtetutën. Serbia kërkon që Kosova t'i zbatojë marrëveshjet e arritura, por Qeveria e Kosovës është deklaruar kundër një asociacioni njëetnik. Vitin e kaluar zyrtarë evropianë e kanë përpiluar një draft-statut për Asociacionin, i cili është pranuar në parim. Por, më vonë, kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, e ka cilësuar këtë dokument si "non-paper". Në gjuhën e institucioneve evropiane, non-paper është një dokument joformal, i cili ekspozohet në negociata të mbyllura brenda institucioneve të BE-së, në përpjekje për të gjetur marrëveshje për ndonjë çështje të kontestuar. Kurti ka thënë më herët gjatë javës në një intervistë për A2CNN, se

emisari i BE-së për dialogun Kosovë - Serbi, Miroslav Lajçak, mund ta dërgojë draftin për Asociacionin në Komisionin e Venedikut. Bashkimi Evropian ka reaguar ndaj kësaj deklarate, duke thënë se marrëveshja e Brukselit për Asociacionin nuk parasheh diçka të tillë. Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe angazhohet vazhdimisht në fushata lobuese kundër Kosovës. Dy vendet dialogojnë në Bruksel për normalizim të marrëdhënieve që prej vitit 2011. Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar. Bashkimi Evropian ka përsëritur disa herë se zgjidhja e të gjitha problemeve mes dy vendeve është faktor tejet i rëndësishëm për rrugën e tyre evropiane.

## Gërvalla për Osmanin: S'kemi nevojë të pajtohemi gjithmonë 100 për qind

Përgjatë intervistës për KosovaPress, ministria Gërvalla ka folur edhe për marrëdhëniet e saj me presidenten e Kosovës, Vjosa Osmani. Diskutimet në këtë drejtim janë rritur secilën herë e më shumë, pasi Presidenca e Kosovës ka thënë se qeveria nuk është konsultuar me të lidhur me hapat që ka bërë Kosova për anëtarësim në Këshill të Evropës. "Ne me presidenten e Republikës raportet gjithmonë i kemi pasur të mira dhe nuk kam asnjë arsye të mendoj që ka një ndryshim në raportet tona. Unë jam e mendimit që nuk kemi nevojë gjithnjë të pajtohemi 100 për qind për të gjitha temat. Natyrisht që si persona që bartin përgjegjësi të shumta, në sfera të ndryshme, nganjëherë për procese të ndryshme, kemi edhe mendime të ndryshme". Sipas saj, edhe kur ekzistojnë dallimet mes zyrtarëve të lartë shtetërorë, ata gjejnë "një rrugëdalje dhe gjuhë të përbashkët". Kurti ka thënë ditë më parë se nuk beson që ekzistojnë dallime të patjetkueshme mes tij dhe krerëve të tjerë shtetërorë, përfshirë presidenten Osmani. Vetë Osmani ka thënë se dallimet janë të tejkalueshme kur interesi shtetëror dhe qytetar vendoset mbi të gjitha.



## Shefi i EULEX-it: Banjska e ka dëshmuar brishtësinë e veriut

Shefi i misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano, ka thënë të dielën se sulmi në Banjskë të Zveçanit e ka dëshmuar brishtësinë dhe cenueshmërinë e veriut të Kosovës dhe ka bërë thirrje për dhënie fund të tensioneve dhe krizave. Shefi i EULEX-it ka thënë se misioni që udhëheq e ka rritur shkallën e vigjilencës për të mos lejuar përsëritjen e ndonjë krize dhe e di që Kosova ka përforcuar praninë dhe kapacitetet e veta përgjatë kufirit

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Shefi i misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë (EULEX), Giovanni Pietro Barbano, ka thënë të dielën se sulmi në Banjskë të Zveçanit e ka dëshmuar brishtësinë dhe

cenueshmërinë e veriut të Kosovës dhe ka bërë thirrje për dhënie fund të tensioneve dhe krizave. Ai i ka bërë këto deklarata në një intervistë për agjencinë e lajmeve KosovaPress. “Banjska e ka

dëshmuar brishtësinë dhe cenueshmërinë e kësaj zone. Prandaj, kjo zonë kërkon vëmendje të veçantë. Ne jemi vigjilentë për të parandaluar çdo rikthim të mundshëm të dhunës”.

Më 24 shtator të vitit të kaluar, një grup i armatosur serbësh e ka sulmuar Policinë e Kosovës në Banjskë, duke lënë të vrarë rreshterin Afrim Bunjaku.

Në shkëmbim e sipër të zjarrit janë vrarë edhe tre sulmues.

Kosova e konsideron Serbinë përgjegjëse për organizim dhe kryerje të sulmit, por Beogradi mohon gjithçka.

Shefi i EULEX-it ka bërë thirrje që Serbia të bëjë të pamundurën për ta parandaluar përsëritjen e

ndonjë situatë sikurse ajo në Banjskë. “Presim prej Serbisë që ta ushtrojë fuqinë që ka për të mbajtur përgjegjës ata që e kanë kryer sulmin”.

Përgjegjësinë për sulmin në Banjskë e ka marrë ish-nënkryetari i Listës Serbe, Millan Radoiçiq.

Ndonëse ndaj tij është shpallur një fletarrestim ndërkombëtar, ai gjendet i lirë në Serbi.

Shefi i EULEX-it ka thënë se misioni që udhëheq e ka rritur shkallën e vigjilencës për të mos lejuar përsëritjen e ndonjë krize dhe e di që Kosova ka përforcuar praninë dhe kapacitetet e veta përgjatë kufirit.

“Nëse diçka ndodh prapë, atëherë ajo do të nënkuptonte që me shumë mundësi, institucionet në Serbi

kanë dështuar ta parandalojnë një sulm”.

Policia e Kosovës është përgjegjëse e parë për sigurinë e Kosovës, EULEX-i i dyti, ndërsa misioni i NATO-s në Kosovë, KFOR, i treti.

Barbano ka bërë thirrje që Kosova dhe Serbia të angazhohen në dialog dhe t'i zgjidhin të gjitha çështjet përmes atij kanali.

Serbia nuk e njeh pavarësinë e Kosovës dhe angazhohet vazhdimisht në fushata lobuese kundër Kosovës.

Dy vendet dialogojnë në Bruksel për normalizim të marrëdhënieve qysh prej vitit 2011. Palët kanë nënshkruar një mori marrëveshjesh, por jo të gjitha janë zbatuar.

## Murati thotë se numri i bashkatdhetarëve që po kthehen të investojnë e punojnë në Kosovë po rritet

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve, Hekuran Murati, ka thënë se numri i bashkatdhetarëve që po kthehen të investojnë e punojnë në Kosovë po rritet dita ditës. Përmes një postimi në “Facebook”, ai ka pretenduar se këtë po e shohin në të gjithë

sektorët. “Numri i bashkatdhetarëve që po kthehen të investojnë e punojnë në Kosovë po rritet dita ditës. Këtë e shohim pothuajse në të gjithë sektorët - duke filluar nga shërbimet digjitale, energjia e ripërtërishme, e deri te bujqësia”, ka shkruar Murati të dielën. Më tutje, ai ka thënë se

do të lansohet një instrument i ri që do të mundësojë katalizimin dhe rritjen e mëturshme të investimeve të mërgatës në Kosovë. “Sepse bashkatdhetarët tanë e njohin potencialin zhvillimor të vendit më mirë se cilido investitor tjetër i huaj”, ka deklaruar Murati.



# Vazhdon rënia e numrit të popullsisë në Kosovë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Në Kosovë po vazhdon trendi i rënies së numrit të popullsisë. Sipas ekspertëve, faktorët që kanë ndikuar në këtë trend janë emigrimi dhe rënia e natalitetit. Ata u bëjnë thirrje institucioneve shtetërore që të hartojnë politika për uljen e emigrimit.

Mbi 1.7 milion ishte numri i banorëve në Kosovë në vitin 2011, kur është bërë regjistrimi i popullsisë. Nga atëherë deri sivjet, kur u bë regjistrimi i fundit, sipas të dhënave, ka vazhduar të ketë rënie të numrit të popullsisë. Këtë vit, nga 5 prilli deri më 24 maj, u zhvillua procesi i regjistrimit të popullsisë, ndërsa Agjencia e Statistikave në konferencat e fundit ka bërë me dije se të dhënat fillestare pritet të publikohen në korrik, ndërsa ato përfundimtare në fund të këtij viti.

Ekspertët thonë se në rënie të numrit të popullsisë kanë ndikuar emigrimi dhe ulja e natalitetit.

Demografi Sami Behrami tha për Radio Kosovën se kjo është

shqetësuese dhe se tani është koha e fundit që institucionet të merren seriozisht me problemin e migrimit.

Edhe Besim Gallopi nga Shoqata e Sociologëve të Kosovës tha se faktorët kryesorë janë lëvizjet e popullsisë dhe numri i ulët i lindjeve. Ai theksoi se pasojat mund të jenë të mëdha në të gjitha fushat.

Gallopi theksoi se trendi i rënies së numrit të popullsisë është vërejtur në të gjitha vendet e rajonit dhe të Evropës. Më tutje ai theksoi se institucionet vendimmarrëse në Kosovë duhet të kenë një vëmendje të shtuar në mënyrë që të kenë një organizim konform gjendjes në terren, duke ndërmarrë hapa në ndërtimin e politikave, që ky trend i emigrimit të ulet.

Në raportet vjetore të Agjencisë së Statistikave të Kosovës (ASK), dhjetëra-mijëra persona largohen çdo vit nga Kosova drejt vendeve të huaja. Ndërsa para gjashtë muajve, ASK-ja bëri me dije se vetëm gjatë vitit 2022 e kanë lëshuar Kosovën mbi 41 mijë persona.



## Ziberi: Shkalla e vdekshmërisë nga kanceri në Ballkan, shumë më e lartë sesa në BE



Prishtinë, 9 qershor - Vendet e Ballkanit kanë një përqindje shumë më të lartë të vdekshmërisë nga sëmundjet që kanë lidhje me kancerin sesa vendet e Evropës Perëndimore. Bashkim Ziberi, profesor i fizikës mjekësore në Universitetin e Tetovës dhe aktivist i shëndetit botëror, thotë në një intervistë për Zërin e Amerikës se, pavarësisht se numri i të prekurve me kancer në Ballkan është më i ulët sesa në BE, shkalla e vdekshmërisë në

Ballkan është 60 %, ndërsa në vendet e bllokut evropian është 35 %.

Gjatë bisedës, profesor Ziberi, i cili ka qenë pjesëmarrës i programit Fulbright në Institutin për Kancerin "Dana Farber" të Universitetit të Harvardit, sqaron arsyet pse ekziston ky dallim i madh. Ai ndodhet këto ditë në Uashington si bashkorganizator i takimit për shëndetin botëror që ka për qëllim ta zbusë pabarazinë në zbulimin e

hershëm dhe trajtimin e pacientëve me kancer në vendet me të ardhura të ulëta në raport me vendet e zhvilluara. "E dimë të gjithë që sëmundjet që kanë lidhje me kancerin janë faktori numër një i vdekjeve në botë. Në vendet e zhvilluara dhe në vendet në zhvillim është faktori i parë apo i dyti. Vendet tona hyjnë në listën e vendeve në zhvillim. Ka publikime të ndryshme shkencore që nga njëra anë tregojnë se numri i rasteve me kancer në vendet

tona është më i ulët sesa në vendet e Bashkimit Evropian apo vendet e Evropës perëndimore por, nga ana tjetër, vdekshmëria është shumë më e lartë. Nëse mbështetemi në këto të dhëna shkencore, vdekshmëria në vendet e Ballkanit është rreth 60 për qind, ndërsa në vendet e Evropës perëndimore kjo shifër është 34 apo 35 %", ka theksuar Ziberi, duke shtuar se në vendet tona kanceri numër një është ai i mushkërive dhe në pjesën më të

madhe ka të bëjë me konsumimin e lartë të duhanit. "Lloji tjetër është kanceri i gjirit te gratë, pastaj kanceri i zorrës së trashë, e kështu me radhë. Duhet përmendur se një pjesë e këtyre llojeve të kancereve kanë mundësi të mira shërimi nëse mund të zbulohen me kohë. Ka edhe lloje të tjera të kancereve që janë më vdekjeprurëse dhe që janë në përqindje më të vogël te pacientët, por që vdekshmëria është mbi 95 % siç është kanceri i pankreasit", ka pohuar ai.

## Brenda pesë muajve 511 prishtinas u kafshuan nga qentë

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Nga muaji janar deri në maj në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në kryeqytet janë raportuar dhe trajtuar 511 raste që

kanë pësuar apo janë sulmuar nga qentë endacakë. Në fakt, brenda këtyre pesë muajve është shënuar pothuajse dyfishi i rasteve krahasuar me

periudhën janar-qershor të 2023-s ku kishin qenë 263 sulme nga qentë endacakë. Mirëpo një karakteristikë tjetër është se në muajin maj janë paraqitur 28 qytetarë të

cilët janë kafshuar nga sorrat. Dhe krahas këtyre, ndihmë mjekësore kanë kërkuar edhe 9 qytetarë që janë kafshuar nga macet. /klankosova/



## Shkurte Fejza dhuroi atmosferë të zjarrtë me koncertin e saj. Faleminderit ikonë e muzikës!

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Me këngë të paharrueshme që për pesë dekada ka mbajtur gjallë atdhedashurinë e shqiptarëve dhe rezistencën e tyre, të shtunën në mbrëmje këngëtarja Shkurte Fejza i solli publikut emocione të mëdha në koncertin "Shkurte Fejza - 50 vjet, Zëri i Kombit".

50 vitet e karrierës së saj nuk kishin si të festoheshin më mirë se në 25-vjetorin e çlirimit të Kosovës.

Në sallën e madhe të Pallatit të Rinisë dhe Sporteve në Prishtinë, Shkurte Fejza me zërin e saj të mrekullueshëm dhe me këngët folklorike, popullore dhe ato të lehta solli para publikut atmosferë të paharrueshme. Bashkë me të performuan edhe këngëtarët Ilir Shaqiri, Kastriot

Tusha, Nikollë Nikprelaj dhe dy vajzat e saj, Gresa dhe Besiana. Gjithmonë të shoqëruar nga orkestra simfonike e përbërë nga orkestra e Shotës dhe instrumentistë të tjerë.

Në mesin e shumë qytetarëve që ndoqën nga afër këtë koncert madhështor, të pranishëm ishin edhe presidentja Vjosa Osmani, kryeparlamentari Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, ministri Hajrulla Çeku, zëvendëskryeministrja dhe ministrja e MPJD, Donika Gërvalla, deputetë, zëvendësministra dhe anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar.

Koncerti është mbajtur në përkujdesjen e Ministrisë së Kulturës, ndërsa është organizuar nga Radio Televizioni i Kosovës.



## Fshati Olimpik e kthen Prishtinën në qendër ballkanike sportive

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Prishtina do të jetë kryeqendër ballkanike e sportit më 2030. Lojërat Olimpikë Mesdhetare, të drejtën për organizimin e të cilave kryeqyteti e fitoi vjet, e garanton këtë status. Kjo e ka bërë të domosdoshëm përsheptimin e planeve për Kompleksin e Sporteve, që merr formën dhe titullin e Fshatit Olimpik.

Në 60 hektarë, hapësirat sportive, ato administrative e afariste dhe akomodimi, janë ndarë në tre shirita që mes vete komunikojnë përmes lëvizjes në këmbë dhe me biçikletë mbi tokë, ndërkaq nëntokë janë parkingjet për makina.

Salla të sporteve të ndryshme, stadiumi qendror dhe fusha të tjera ndihmëse janë të vendosura në qendër të këtij projekti të madh. Në njërin anë janë hapësirat rezidenciale për



sportistët, në anën tjetër hapësirat administrative në të cilat mund të vendosen federatat sportive dhe ato afariste që i japin gjallëri gjithë zonës.

"Shumë përtej Lojërave Olimpikë, ky kompleks sportiv i jep Prishtinës, qytetit tonë të

dashur, dimensionin e munguar të një qyteti të rëndësishëm sportiv në Ballkan. Prishtina e së ardhmes - kryeqytetit i sportit - është përcaktim i kryeqytetit", ka thënë Përparim Rama, kryetar i Prishtinës.

## Dogana konfiskon pjesë rezervë për makineri të rënda në vlerë mbi 7 mijë euro

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Dogana e Kosovës ka njoftuar se ka kapur sasi të konsiderueshme të mallrave të padeklaruar në pikën kufitare Vërmicë. Mallrat e konfiskuara janë kryesisht pjesë rezervë për makineri të rënda. "Në hyrje të pikës kufitare të kontrollit në Vërmicë ka arritur një veturë e drejtuar nga shtetas turk. Në pyetjen e zyrtarit doganor nëse kishte diçka për të deklaruar për zhdoganim, ai është përgjigjur negativisht. Pas kontrollit të detajuar në vijën e dytë, së bashku me zyrtarët policorë, është zbuluar një sasi e konsiderueshme e mallrave të padeklaruar: 'Pjesë rezervë për



makineri të rënda'. Gjatë kontrollit është gjetur edhe fatura e blerjes së mallrave. Vlera totale e këtyre mallrave është 7 900.00 euro", bëhet me dije në njoftim. Më tutje thuhet se personi ka vepruar në kundërshtim me Kodin Doganor dhe ka shkaktuar kundërvajtje doganore.

## Mbahet testi me shkrim për kandidatë për prokurorë të rinj të shtetit



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) ka organizuar mbajtjen e testit me shkrim në kuadër të procesit të rekrutimit të njëzetekatër (24) prokurorëve të rinj të shtetit, i cili është duke u mbajtur në Akademinë e Kosovës për Siguri Publike në Vushtrri. Në njoftimin e bërë për medie

thuhet se në testin me shkrim janë duke marrë pjesë 281 kandidatë, prej tyre 150 meshkuj dhe 131 femra, prej të cilëve dy janë pjesëtarë nga radhët e minoriteve.

Kryesuesi i Komisionit për Rekrutimin e Prokurorëve të Shtetit, Blerim Isufaj, së bashku me anëtarët e tjerë, është duke mbikëqyruar

rjedhën e mbajtjes së testit me shkrim. "Ky proces është zhvilluar në mbikëqyrjen e monitoruesve të EULEX-it dhe OSBE-së", thuhet në njoftim. Më tutje theksohet se Këshilli Prokurorial i Kosovës bën me dije se do të japë informacione me kohë për rrjedhën e procesit të mëtejshëm.

## Komunat akuzojnë qeverinë për mungesë të financimit të projekteve

PRISHTINË, 9 QERSHOR - Disa prej komunave të Kosovës akuzojnë qeverinë për mungesë të mbështetjes dhe financimit në projekte të ndryshme. Në komunën e Prizrenit, Lipjanit dhe Hanit të Elezit, thonë se vështirësitë e bashkëpunimit me nivelin qendror janë të mëdha. Sipas tyre, qeveria ka bërë diskriminim buxhetor në komunat që u takojnë partive politike, të kundërta me partinë në pushtet.

Nënkryetari i komunës së Prizrenit, Kujtim Gashi, thotë për KosovaPress se mbështetja e nivelit qendror për këtë komunë është shumë e vogël krahas kërkesave dhe nevojave që i kanë. Ai shton se burokracia në ministri të linjave po shkakton vonesa të mëdha, siç është rasti me bartjen e mjeteve buxhetore nga viti paraprak. "Nëse i referohem mbështetjes prej nivelit qendror, faktikisht prej ministrive për projekte që janë të rëndësishme

në fusha të ndryshme, ka mungesë të financimit nga niveli qendror. Komuna e Prizrenit është komuna e dytë në Kosovë për nga numri i banorëve dhe për nga kërkesat dhe nevojat e shumta që ka. Në këtë kuptim mbështetja e nivelit qendror është shumë e vogël, përjashtimisht projekte që kanë filluar vite më parë dhe që realizohen tani. Përndryshe, projekte të reja, projekte që komuna vazhdimisht ka bërë kërkesa, nuk kemi të atij niveli. Ajo që është më e keqe se kaq është burokracia që ekziston në ministri të ndryshme, në kuptimin e koordinimit. E veçanta e asaj është se vendimet e Asamblesë Komonale që obligohen të shqyrtohen në ministri të linjës kanë vonesa të jashtëzakonshme. Shembull është rasti i bartjes së mjeteve nga viti paraprak", thotë Gashi.

Ndërkaq, kryetari i komunës së Lipjanit, Imri Ahmeti, thotë se problemet me qeverinë janë më të



theksuar në rastet e rishikimeve buxhetore dhe bartjen e të hyrave vetjake. Sipas tij, vonesa më të mëdha ka në alokimin e mjeteve dhe zotimin e tyre për projekte të caktuara. "Problemet janë më të theksuar në rastet e rishikimeve buxhetore, pasi ridestini s'ka. Po ashtu, edhe në bartjen e të hyrave vetjake. Natyrisht se ka vonesa të theksuara në alokimin e mjeteve sepse neve na duhet edhe zotimi i mjeteve për të publikuar projekte

të caktuara që i kemi në agjendë. Vështirësitë nuk janë të vogla, në kuptimin e komunikimit që duhet të ketë pushteti lokal me pushtetin qendror. E gjithë kjo pason në zvarritjen e implementimit të projekteve", ka deklaruar Ahmeti. Kritika më të ashpra ndaj ekzekutivit adreson kryetari i komunës së Hanit të Elezit, Mehmet Ballazhi. Ai shpreh pakënaqësinë e tij, siç thotë, për mosmbështetjen e qeverisë ndaj

komunës që drejton. "Ne kemi shprehur shqetësimet tona për një bashkëpunim të zbehtë me nivelin qendror edhe pse kjo s'do të kishte dashur të ndodhte kështu. Ne jemi pjesë e territorit të Kosovës dhe bëjmë pjesë në tërësinë territoriale të saj. Nuk është se kam ndonjë kënaqësi për këtë bashkëpunim, i cili nuk ka ndodhur asnjëherë me qeveritë e kaluara. Është dashur mos të ketë diskriminim buxhetor, pasi shihet se në komunat që u takojnë partive politike, të kundërta me qeverinë në pushtet. Kjo duhet të ndryshonte. Unë personalisht si kryetar komune nuk jam i kënaqur me bashkëpunimin që deri tani e kemi", ka theksuar Ballazhi. Përkundër të kritikave të komunave që udhëhiqen nga partitë opozitare në Kosovë, kryeministri Albin Kurti vazhdimisht ka theksuar se gjatë qeverisjes së tij është rritur përkrahja e ekzekutivit ndaj nivelit lokal.

## Temperaturat e larta në Kosovë shqetësojnë bujqit



PRISHTINË, 9 QERSHOR - Temperaturat që po mbretërojnë në ditët e fundit, mbi 30 gradë celsius, kanë nisur t'i shqetësojnë bujqit. Ata druajnë se i nxehti i madh do t'ia humbë peshën specifike grurit. Andaj, vlerësohet se mund të ketë ulje të prodhimit të grurit nga 20 deri në 30 %.

Profesori universitar i Bujqësisë, Imer Rusinovci, tha se mund të kemi ulje të prodhimit nga 20 deri në 30 %. "Kjo dukuri përkon me stërpikjen e grurit ose pjekjen e dhunshme, që quhet vala e nxehtë dhe zakonisht koïncidon me reduktim të prodhimit për 20 deri në 30 %, varësisht se sa zgjat kjo ngrohje", tha Rusinovci për RTK-në. Fermeri Valon Vehapi, i cili këtë vit ka mbjellë grurë afër 80 hektarë, ngrë shqetësimin se nëse në ditët në vijim temperaturat janë të larta, gruri mund ta humbë peshën specifike. "Në bujqit gjatë tërë vitit lutemi që mos të kemi në fund të majit dhe fillim të qershorit ngritje të temperaturave, për arsye se këto ditë, nga 25 maji deri më 10

qershor, gruri e mbush kokrrën, e plotëson, e nëse temperaturat janë mbi 30 gradë, gruri fillon e ngut procesin dhe bëhet rrudhja e kokrrës", tha ai.

Shqetësim të njëjtë ka edhe fermeri tjetër Mehdi Bresilla, i cili ka 4.5 hektarë sipërfaqe të mbjella me grurë. "Unë pres t'i marrë 7 500 - 8 000 kg për hektar, po kjo nuk do të ndodhë, sepse nuk do të kemi rendiment fare ose 1 000 - 2 000 kg kualitet shumë të dobët dhe krejt kokra e grurit do të shteret dhe ka për të shkuar bashkë me frymë", tha ai.

Sipas parashikimit të motit, java në vazhdim do të arrijë temperatura rreth 30 gradë. Instituti Hidrometeorologjik thekson se shkalla e avullimeve është e lartë dhe në këto temperatura të larta edhe humbjet e sasive të lagështisë të cilat u formuan si rezerva gjatë muajit maj janë duke humbur, mesatarisht 5 litra për metër katror, gjë që edhe kushtet agrometeorologjike thuhet se janë duke u keqësuar.

## BQK-ja, rritja ekonomike e Kosovës për vitin 2024 do të jetë 3.9 për qind

Prishtinë, 9 qershor - Projektionet e BQK-së për vitin 2024 sugjerojnë për një rritje ekonomike prej 3.9-përqindësh si rezultat i rritjes së të ardhurave reale të disponueshme për shkak të rënies së inflacionit dhe rritjes së burimeve të tjera të financimit. BQK në raportin "Vlerësimi tremujor i ekonomisë" shkruan se në TM1 2024 është shënuar ngadalësim i rritjes (3.3 për qind) si pasojë e vlerësimeve për rënie të eksportit të mallrave si dhe rritjes së importit të mallrave dhe shërbimeve, përderisa investimet

e përgjithshme, konsumi, si dhe eksporti i shërbimeve, vlerësohet se ndikuan pozitivisht rritjen e BPV-së.

Në këtë raport flitet edhe për perspektivën e inflacionit në Kosovë. "BQK parashikon që inflacioni në vitin 2024 të ngadalësohet në 2.5 për qind. Faktorët që pritet të kontribuojnë në këto dinamika përfshijnë stabilizimin e ofertës dhe çmimeve në tregjet ndërkombëtare krahas ngadalësimit të aktivitetit ekonomik global, trendit zbritës

të inflacionit në eurozonë, transmetimit të shtyrëngimit të kushteve të financimit në kërkesën e brendshme e të tjera", thuhet në raport.

Po në raport flitet për rreziqet e ndërlidhura me inflacionin që anojnë nga kahu i lartë dhe që kryesisht përbëhen nga rreziqet për pengesa në zinxhirët e furnizimit si pasojë e tensioneve gjeopolitike, reduktimit të sasisë së prodhimit nga OPEC+, ndikimit të migrimit potencial në paga pas liberalizimit të vizave e të tjera.



# FSHESA HISTORIKE E STROBE TALBOTT NË KUMANOVË

Strobe Talbott (Nelson Strobridge "Strobe" Talbott III)



Ismet SYLEJMANI

Zëvendës Sekretari Amerikan i Shtetit, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Strobe Talbott, është një nga figurat e shquara të administratës së SHBA-së në periudhën e luftës të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe me rol kyq në arritjen dhe zbatimin e Marrëveshjes ushtarako-teknike të Kumanovës, më 9 Qershor 1999!

Zëvendës Sekretari Amerikan i Shtetit, të Shteteve të Bashkuara të Amerikës z. Strobe Talbott, ashtu si edhe shumë figura tjera të mëdha të SHBA-së, përfaqeson shtresën e aristokracisë së lartë të kupolës historike të SHBA-së, të cilët, përgjithmonë do të mbeten në zemrën e çdo shqiptari patriot dhe atdhetar, sepse e bënë të mundur përgjithmonë çlirimin, lirinë dhe pavarësinë e Kosovës nga Serbia pushtuese!

9 Qershori 1999, shënon momentin kulmant kur në Kumanovën legjendare, nënshkruhet Marrëveshja Historike e kapitullimit total politiko-ushtarak të Serbisë pushtuese dhe aty është

momenti i madh dhe historik i qëndrimit spektakular të diplomatit të lartë Amerikan z. Strobe Talbott!

Diplomati legjendar Amerikan z. Strobe Talbott, ka luajtur rolin e Tij brilant për lirinë dhe çlirimin historik të Kosovës dhe sidomos për largimin e të gjithë aparatit shtypës dhe vrasës ushtarak dhe paramilitar të forcave serbe nga Kosova!

Boshatisja totale si me fshesë e çdo trupe pushtuese serbe, mbetet një nga meritat e veçantë historike të veprimeve diplomatike dhe të kokëfortësisë së këmbënguljes së Tij të madhe në arritjet e Marrëveshjes së Kumanovës!

Marrëveshja ushtarako-teknike e Kumanovës në pikën e saj C) ka një tekst, i cili përfshinë një tërësi totale!

C-ja e Marrëveshjes së Kumanovës, është përmbyllja e ëndrrës shekullore të qindra dhe mijëra gjeneratave atdhetare dhe patriotike të popullit shqiptar!

C-ja e Marrëveshjes së Kumanovës, është realizimi në tërësi i platformave politiko-patriotike të të gjitha organizatave, lëvizjeve dhe partive politike në Kosovë e jashtë saj!

C-ja e Marrëveshjes së Kumanovës, është homazh me nderim e qetësi oqeanike, sepse aty nderimi për të gjithë Dëshmorët, Heronjtë, Martirët, Invalidët e luftës së armatosur e çlirimtare të UÇK-së, ish - të burgosurit politik, veprimtarë e aktivistë të panumërt kombëtar, u



STROB TALBOTT

bë realitet faktik!

c) "...nga Kosova të largohen të gjithë personat dhe organizatat me aftësi militare duke përfshirë armatën e rregullt dhe forcat e marinës, civilë të armatosur, paramilitarë, forcat ajrore, garda kombëtare, policia kufitare, rezervistët, policia ushtarake, shërbimet informative, MUP-i, policia lokale, speciale, antirebeliste, antiterroriste dhe çdo grup i përcaktuar nga KFOR-i...!"

Informacionet dhe e vërteta e madhe historike, flasin se Zv. Sekretari Amerikan i Shtetit të SHBA-ve z. Strobe Talbott, ka qenë njëri ndër hartuesit dhe këmbën-

gulesit kryesorë, që asgjë, ama bash asgjë e aparatit shtypës, vrasës, gkapirës epushtues represiv, dhunues e gjenocidal serb, të mos mbetet në territorin e Kosovës, i cili do të kontrollohej nga NATO! Populli shqiptar i Kosovës, i është mirënjohës përgjithmonë mikut të tij të madh, Zëvendës Sekretarit Amerikan të Shtetit të SHBA-ve z. Strobe Talbott, për rolin dhe qëndrimin e pathyeshëm historik, përballë negociatorëve serb, në arritjen përfundimtare e finale të Marrëveshjes historike ushtarako-teknike të Kumanovës!

Faleminderit shumë i dashur dhe shumë i nderuar Zëvendës Sekretar

Amerikan i Shtetit z. Strobe Talbott!

Nga zemra e madhe e popullit shqiptar, buron pashtershmë, por edhe do të burojë në shekuj, falenderimi për Ty e për Amerikën Tënde, për Amerikën e madhe dhe legjendare, që na e bëtë të mundur, që gjithëçka pushtuese serbe, si me fshesë, të largohej njëherë e përgjithmonë nga Kosova, për të mos u kthyer kurrë më!

Kombi ynë do ta mbajë të pashlyer kujtimin për Fshesën Tënde historike, që zhbëri gjithëçka pushtuese serbe nga Kosova!

Prishtinë, 9 Qershor 2024!



# “Tërmet” politik në Francë dhe Gjermani, ekstremistët e djathtë ‘shtypin’ Scholz dhe Macron



Bazuar në exit poll-et e para, harta e re e Europës që mund të vizatohej nga këto zgjedhje ka nisur të marrë formë. Në pritje të rezultateve përfundimtare, sondazhet e kryera në vendet kryesore evropiane nxjerrin fitues Konservatorët e djathtë, të ndjekur nga ekstremistët e djathtë.

## Gjermania

Kancelari gjerman Olaf Scholz dhe partia e tij, SPD, janë mposhtur plotësisht sipas exit poll-eve të para në Gjermani me ekstremistët e AfD që bëhen forcë e dytë duke shkakuar një tërmet politik. Partia Popullore e CDU/CSU (një parti që i përket PPE) është partia kryesore me 30%. Ekstremistët e djathtë të AfD me 16% kalojnë socialistët e SPD me 14% duke dalë për herë të parë forcë e dytë në vend. Sipas exit polleve radha më pas është e tillë: Të Gjellbrit 12,5%, BSW 6%, FDP 5%, Sinistra (Linke) 3% Volt 3%.

Kreu i AfD-së, Tino Chrupalla ka shprehur gëzimin për arritjen në këto zgjedhje edhe pse rezultatet finale pritet të dalin në orët e para të mëngjesit. “Loja mbaroi dhe kemi një super rezultat, një rezultat rekord. Ne kemi pothuajse 50% të votuesve të rinj në Evropë”, tha ai.

Ndërkohë, Kevin Kühnert, sekretari i përgjithshëm i Social Demokratëve të kryeministrit Olaf Scholz ka shprehur dëshpërimin

duke thënë: “Kjo është një humbje e rëndë për ne sot”.

## Greçia

Sondazhet në fqinjën jugor të Shqipërisë vendosin në krye konservatorët e “Demokracisë së Re”, për të cilët garojnë edhe dy minoritarët, Fredi Beleri e Pirro Dhima. Forca politike e drejtuar nga kryeministri Kyriakos Mitsotakis, pjesë e PPE-së, kryeson sipas exit polleve me 28-32% të votave.

Ajo ndiqet nga SYRIZA e grupit të majtë në Parlamentin Evropian mes 15.2 dhe 18.2%. PASOK me shumë gjasa do të jetë në vendin e tretë, në pragun midis 13.9 dhe 10.9%, pasuar nga komunistët e KKE mes 10.3 dhe 7.9% dhe partia e ekstremit të djathtë Ellinikilisi (Zgjidhja greke) që mund të marrë deri në 7.6% të votave.

## Austria

Exit poll-et e para, të publikuara nga media në mbyllje të sondazheve, tregojnë se partia e ekstremit të djathtë FPÖ është në krye me 27% të votave në Austri. Partia Popullore Konservatore është në vendin e dytë me 23,5%, dhe Socialdemokratët në vendin e tretë me 23%. Për FPÖ ky është një rezultat historik, pasi partia është formacioni kryesor politik në vend për herë të parë. Pesë vjet më parë ajo u ndal në pragun

17%. Mbështetja për partinë e ekstremit të djathtë ishte shembur pas skandalit “Ibizagate”, i cili e përfshiu atë në vitin 2019, kur ish-lideri i saj u kap “mat” duke i premtuar kontrata qeveritare një gruaje që paraqitej si mbesa e një oligarku rus.

## Slovakia

Në Sllovaki, sipas parashikimeve fillestare, partia opozitare e majtë-liberale Sllovakia Progressive mund të fitojë me 28% të votave. Kjo do të ishte tre pikë për qindje më shumë se partia populiste e majtë Smer (Drejtimi) e kryeministrit Robert Fico. Në vendin e tretë është partia nacionaliste e ekstremit të djathtë Republika me 12.5%, e ndjekur nga partia e majtë Hlas (Zëri) me 7%. Partia Kombëtare Sllovaqe (SNS), gjithashtu në qeveri shkërmoqet dhe nuk arrin as 2%.

## Qipro

Qendra e djathtë është përpara në Qipro në zgjedhjet evropiane siç tregohet nga sondazhet e para. Kristian Demokratët e Disy (pjesë e PPE) janë të parët, në një gamë që shkon midis 25.5 dhe 28.5%, të ndjekur nga marksist-leninistët e Akelit (E majta), midis 23 dhe 26%. Në vendin e tretë ishte surpriza e vërtetë e zgjedhjeve në ishullin mesdhetar. 12 deri në 15% të votave parashikohet të ketë marrë

Fidias Panayiotou, një YouTuber shumë i famshëm në Qipro, i cili u paraqit në votime si një kandidat krejtësisht i pavarur. Në YouTube, kanali i Panayiotou ka 2.6 milionë ndjekës, më shumë se dyfishi i popullsisë totale të ishullit të Qipros.

Partitë Diko dhe Edek - të dyja në grupin S&D në Dhomën Evropiane - kanë ngecur në vendin e katërt dhe të pestë. E para është midis 7.5% dhe 10.5%, ndërsa e dyta midis 3.5 dhe 5%.

## Malta

Malta, një vend famëkeq dypartiak, është i ndarë, sipas vlerësimeve të para të publikuara nga Parlamenti Evropian. Partia Laburiste e kryeministrit Robert Abela pritet të marrë 3 eurodeputetë me 44.67%, 1 më pak nga 2019. Në të njëjtën kohë, Partia Nacionaliste, e cila i përket familjes konservatore, do të merrte tre deputetët e tjerë me 42.52% të votave.

Robert Metsola, presidentja në detyrë e Parlamentit Evropian, vjen nga Partia Nacionaliste dhe për këtë arsye është e garantuar që do të rizgjidhet si ligjvënës në PE.

## Kroacia

Vlerësimet e para nga Kroacia janë për një fitore të qendrës së djathtë të kryeministrit Andrej Plenkoviç me 33.74% të votave, që

do të përkthehej në gjashtë eurodeputetë. Sipas një sondazhi nga agjencia e lajmeve HINA kjo do t'i jepte Bashkimit Demokratik Kroat (HDZ) dy ligjvënës të tjerë, nga katër që ka sot. Aleanca e qendrës së majtë e SDP, e cila përzien liberalët dhe socialistët, do të vinte e dyta me 27.81% dhe katër eurodeputetë.

Lëvizja e ekstremit të djathtë për Atdheun, me të cilën Plenkoviç nënshkroi së fundmi një marrëveshje koalicioni, do të siguronte 8.67% të votave, por ende nuk është e qartë nëse kjo do të mjaftonte që ata të hynin për herë të parë në Parlamentin Evropian. Ndërkohë të Gjellbrit e Možemos pritet të marrin 5.84% të të gjitha votave, nga 1.8% që morën në 2019.

## Bullgaria

Me 26.2% të votave, koalicioni qeverisës konservator populist besohet se ka fituar shumicën e vendeve në Bullgari, duke siguruar 6 nga 17 ulëse. Shumë prapa, në vendin e dytë, është koalicioni centrist i partive “Ne vazhdojmë ndryshimin”, Volt Bullgaria dhe Bullgaria Demokratike, me 15.7%. Partia e djathtë ekstreme Rilindja vjen në vendin e tretë. Kjo është një fitore e rëndësishme për Revival, pasi ata morën vetëm 1% të votave në 2019 dhe nuk siguruan asnjë vend në Parlamentin Evropian.

# Përgjigjja nuk ishte libri



Berat ARMAGEDONI

Edicioni i 24-t i Panairit të Librit "Prishtina 2024" përfundoi sot. Fjalët dhe fjalitë më poshtë nuk do t'u pëlqejnë aspak organizatorëve. Fjalët më poshtë nuk do t'u pëlqejnë as botuesve. As autorëve. As lexuesve. As udhëheqësve të institucioneve. Asnjë njeriu normal. S'do të duhej t'i pëlqenin as ministrin të Kulturës. Meqë konsideroj se njeri normal jam dhe unë, nuk më pëlqejnë as mua. Megjithatë, duhet thënë nga unë, kush të dojë edhe ta pranojë, se ky ishte edicioni më i dështuar i organizuar që prej origjinës së tij në Kosovë nga e njëjta shoqatë e, pothuajse, edhe nga po të njëjtit persona. Botuesit, ndoshta edhe organizatoren, Shoqatën e Botuesve të Kosovës (ata katër pesë anëtarë shoqate), e shqetësoi numri i vogël i vizitorëve, numri shumë i vogël i të interesuarve për libra të rinj dhe i blerësve. Në ditën e parë të panairit, në mbremje, pas mbylljes së tij, dhashë këtë kumt në llogarinë time në "Facebook": "Nëse 'mbarëvajtja' e nesërme e panairit është si sot, një ditë ky panair i librit vetëm do të kujtohet. Pra, nuk do të shënohet. Më shumë botues se vizitorë. Më shumë staf të botuesve se vizitorë. Kryet në cung e qes, se sot asnjë botues nuk ka shitur pesë ekzemplarë të një titulli. Asnjë botues, asnjë autor, sot nuk është ndier i kënaqur. Kushdo që mburret për ditën e sotme, gënjen. Gjendje më të keqe, interesim më të ulët sesa në këtë edicion, nuk ka pasur në asnjë edicion. Prandaj, nëse ky trend vazhdon, pas pesë viteve ky panair nuk do të ekzistojë as nëse pjesëmarrja e botuesve bëhet pa pagesë, as nëse u ofrohen para botuesve për pjesëmarrje. Këtu do të jemi... Do të shihemi... Do të diskutojmë... Mos i harroni këto fjalë të Armagedonit". Disa miq dhe mikësja shprehën opinione me fjalë, disa të tjerë shprehën befasi e disa të tjerë ironi nëpërmjet simboleve. Botuesit kishin

shpresë se dita e dytë, e tretë, e katërt, e pestë do të jenë më të mira për ta, për librat dhe për autorët. Dorën në zemër, që i bie rri shtrembër e fol drejt, secila ditë ishte pak më shpresëdhënëse se paraparakja. Vizitorë pak më shumë dhe shitje pak më shumë. Por, sa pak më shumë? Në krahasim me tre katër vjet më parë, 60-70 për qind vizitorë më pak, gjithashtu 60-70 për qind shitje më pak. Vinin dhe dilnin nga sallat dhe shatorët e panairit, profesorë universitetesh, kolegësh, arsimtarë, mësues, studiues, hulumtues, drejtues të institucioneve lokale dhe qendrore, politikanë, gazetarë, shkrimtarë, nxënës, afaristë, milionerë, multimilionerë, pa libra në duar. Disa vinin kërkonin libra falas si të ishte kohë krize për bukë. Po kishte edhe prej atyre që kishin libra në duar, në qese najloni dhe letre. Disa libra kishin çmime të shtrenjta, disa të arsyeshme, disa të lira, disa përtokë. Për të pasur sa më shumë punë, për të pasur sa më "llugë" pranë stendave, disa botues milionerë ofruan ulje çmimesh deri 80 për qind, por as kjo joshje nuk i joshi vizitorët. Paketat e bananeve, të mbushura me libra e të futura brenda, përsëri i nxorën jashtë me libra. Edhe pse organizatorja - Shoqata e Botuesve e Kosovës - në hapje të edicionit të sivjetmë dha kumtin se në këtë panair ekspozohen rreth dy mijë tituj të rinj, shumë prej atyre që hynin dhe dilnin nga panairi, si duket, nuk gjenin një titull të ri! Derisa dilnin i dëgjoja që thoshin: "Nuk gjeta gjë". Tituj të rinj kishte nga botues të Kosovës, të Shqipërisë, të Maqedonisë së Veriut mjaft. Absolutisht nuk kanë qenë dy mijë tituj të rinj. As gjysma e tyre. Organizatorët vetëm po i përsëritin të njëjtat fraza si përherë. Edhe të njëjtat statistika të vizitueshmërisë. Nuk e di ku i kanë marrë organizatorët statistikat për dy mijë tituj të rinj e për vizitorë të shumtë. Nga botuesit, jo. Nga Biblioteka Kombëtare e Kosovës, jo. Nga Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë, jo. Nga Biblioteka Kombëtare e Maqedonisë së Veriut, jo. Nga ndonjë anketë, jo. Kushedi nga kush...! E vërteta është kjo (hulumtuar nga bibliotekat që i pajisin librat me cip dhe barkod): tituj të rinj të librave më pak sesa në vitin e kaluar nuk janë botuar që dhjetë vjet, as nuk janë ekspozuar më pak

se sivjet. Por, nuk është numri i vogël i titujve të rinj që ka përgjysmuar numrin e vizitorëve, as numrin e botuesve pjesëmarrës, as të autorëve, të aktiviteteve dhe të blerësve. Është diçka tjetër. Është shumëçka tjetër. Banorët e Kosovës sot kanë më pak para sesa që kishin, një, dy, tri e katër vjet më parë. Edhe po jetojnë më keq sesa më parë ani pse lënë përshtypjen, me publikime të fotografive në rrjete sociale nga vendet evropiane, se po jetojnë më mirë sesa që jetonin më parë. Po e mashtrojnë vetveten dhe po i mashtrojnë të tjerët. Edhe botuesit e Kosovës sot kanë më shumë shpenzime sesa që kishin, një, dy, tri e katër vjet më parë. Ashtu si qytetarëve që u është rënduar barra e jetës nga çmimet e larta të mallrave, ashtu u është rënduar botuesve barra e ekzistencës nga shpenzimet e përgatitjes, të shtypit dhe të shpërndarjes së librit. Njëqind për qind jam i bindur se asnjëri botues, përpos organizatorëve që kanë fituar mjaft shumë, nuk ka nxjerrë asnjë metelik fitim nga ky edicion. Kanë paguar çmim vetëm për imazh të biznesit dhe të autorëve. Shumë prej tyre, sidomos ata të Shqipërisë dhe të Maqedonisë së Veriut, kanë shpenzuar dyfish më shumë sesa që kanë fituar. Dmth., sapo kanë shkëlur në pragun e panairit, sapo kanë lëshuar librat në tavolina, sapo kanë varur pllakatet në stenda, sapo kanë shpërndarë stafin nëpër karrige, kanë nisur të shpenzojnë pa pasur mundësi që shpenzimet t'i mbulojnë nga shitja e librave. "Mbarëvajtjen" e punës së tyre e kam përcjell që nga dita e parë me sy, e kam dëgjuar me vesh nga gojë e tyre, edhe e kam vënë re nga mimika dhe sjellja e tyre. Ankesa e tyre, sikurse e imja, është, në radhë të parë, taksa e lartë për pjesëmarrje. Pse duhet, për një metër katror të stendës, botuesit të paguajnë dyzet euro metrin katror (ata në plate), dyzet euro ata në Sallën e Kuqe, tridhjetë euro ata në sallën përballë saj? Pse kjo pjesëmarrje, që dikujt mund t'i kushtojë deri në 1 050.00 euro vetëm për pesë ditë (me një ditë të shkurtuar nga edicioni paraparak), për shembull "Dukagjini"-t që kishte 30 metra katrorë, mua 440.00 euro për 12 metra, të mos bëhet pa pagesë?! Kini parasysh, Shoqatën e Botuesve të Kosovës, për organizim të

këtij panairi, e ka mbështetur Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit e Kosovës. E ka mbështetur edhe komuna e Prishtinës. Së këndejmi, hapësira e Pallatit të Rinisë i është dhënë pa pagesë. A ka logjikë, që një hapësirë që merret pa pagesë, që një aktivitet që mbështetet nga MKRS-ja dhe nga komuna e Prishtinës, të bëhet me pagesë nga Shoqata e Botuesve për botuesit? Komuna nuk i faturon asgjë Shoqatës, kurse Shoqata u lëshon fatura botuesve, një javë pa nisur panairi, me këtë poshtëshënim: "Afati i pagesës së faturës tri ditë". Sipas logjikës sime, kjo s'ka logjikë. Sipas suajës, kushedi! Edhe ndoshta mund të ketë! A ka logjikë, në njoftimin për medie të kësaj Shoqate, të shkruhet kjo fjali: "Hyrja falas për vizitorë". Në Kosovën tonë, hëpërthë, nuk ka. Dhe, siç po vërehet puna, siç po vërehet "mbarëvajtja" e interesimit, e pjesëmarrësve, s'do të ketë kurrë. Kujtdo që i shkon mendja hyrjen për vizitorë në panair një ditë ta bëjë me pagesë, në panair do të mund të hyjnë vetëm qentë dhe macet pa pengesë. Nëse kryetari i Shoqatës ka ndër mend të organizojë edhe ndonjë edicion të këtij panairi duhet të nisë të mendojë qysh tash për edicionin e ardhshëm. Çfarë duhet të bëjë? Fillimisht ta heqë taksën për pjesëmarrje të botuesve, t'u ofrojë kushte më të mira botuesve dhe vizitorëve në një vend tjetër dhe, gjithashtu, të përgatisë katalog elektronik dhe fizik të botuesve gjithmonë. Aktivitetet t'i shpeshtojë, për të vegjël, për të rinj, për të vjetër, jo vetëm në qershor, por çdo muaj. Asnjë vizitori nuk i është dhënë program i aktiviteteve të panairit. Nuk i është dhënë që dhjetë vjet. Asnjë mjek, as të institucionit publik, as privat, në një sallë me zagushi, në tepihët e së cilës merrje në thua dhe mund të përplaseshe me hundë në dysheme, nuk e pati të pranishëm. Askund një bidon me ujë. Ato aktivitete që i ka përmendur se do t'i shënojë sivjet, sidomos përvjetorët e shkrimtarëve të vdekur, s'u zunë ngoje as në medie, as nga botuesit, as nga vizitorët, as nga autorët. U shënuan zbehtë, disa dështuan krejt. Krejt çfarë pashë në panair, tri katër përrurime librash nga shtëpitë botuese, në një hapësirë të papërshtatshme për

organizim, në të cilën më shumë i dëgjoje bisedat dhe ankesat e botuesve poshtë sesa fjalët e recensentëve dhe të kritikëve lart ballë për ballë publikut. Këto të meta të Shoqatës së Botuesve, që edhe në këtë edicion i paguan botuesit, MKRS-ja, komuna e Prishtinës, Pallati i Rinisë dhe vizitorët, një ditë do t'i shpaguajë vetë Shoqata, së cilës përgjigjja sivjet iu dha bumerang (prapakthehu) nga vizitorët: PËRGJIGJJA JONË NUK ËSHTË LIBRI. Prandaj, vëmendje! Kur ka mundësi komuna e Ferizajt të organizojë panair të librit pa taksë për pjesëmarrje të botuesve dhe t'ua heqë shpenzimet e fjetjes botuesve të Shqipërisë e të pijeve e të ushqimit botuesve të Kosovës; kur ka mundësi komuna e Prizrenit të organizojë panair të librit pa taksë për pjesëmarrje të botuesve dhe t'ua heqë shpenzimet e ushqimit të gjithë botuesve; kur ka mundësi komuna e Pejës të organizojë panair të librit pa taksë për pjesëmarrje të botuesve; kur kanë mundësi edhe komunat e tjera të organizojnë panair të librit pa taksë për pjesëmarrje të botuesve, me një buxhet simbolik prej katër mijë deri në gjashtë mijë euro për organizim, pse nuk ka mundësi Shoqata e Botuesve e Kosovës t'ua mundësojë pjesëmarrjen botuesve pa pagesë që merr për organizim të panairit herë rreth, herë mbi 30 000.00 euro nga institucionet qendrore dhe lokale?! Natyrisht që ka, por po e vazhdon avazin: mbledhjen e taksës dhe vënien e gjobës shtesë prej njëzet eurosh. Më të mira, më të buta e më të shumta janë 70 000.00 - 80 000.00 mijë euro (nga institucionet + botuesit) sesa vetëm mbi 30 000.00 mijë nga institucionet. Pak botues të tjerë këto fjalë i thonë publikisht sepse tuten. Unë pesë para s'i jap. Por, paraja, e dini ju që s'i keni, nuk është gjithçka. Nuk ka qenë kurrë. Paraja nuk e bën njeriun të lumtur. As të suksesshëm. As nuk e bën një botues më të madh sesa një tjetër që ka pak para. Në asnjë edicion të panairit të librit në Prishtinë, as në Ferizaj, as në Prizren, as në Pejë, askund tjetër, nuk kam marrë pjesë vetëm për të shitur libra dhe për t'u bërë pak më i pasur sesa që jam. E kam bërë këtë punë vetëm për librin dhe për autorët. Do ta bëj edhe më tutje siç e bën Azem Zogaj, një

njeri i kulturuar, mbase një prej lexuesve më të mprehtë e të mëdhenj që ka Kosova, i cili më shumë se gjysmën e jetës e ka kaluar duke blerë, lexuar dhe shitur libra. Ai nuk blen dhe shet libra për t'u bërë i pasur. Nuk është bërë i pasur nga shitja e librit. As nuk përpiqet të bëhet. Jeton thjesht, vishet thjesht, ha thjesht. Po ka mendje të ndritur. Leximin e ka pasion. E ndez veturën "Seat Ibiza" në Prishtinë, niset për Pejë. Një ditë tjetër e ndez të njëjtën veturë në Prishtinë dhe niset për Ferizaj. Merr me vete njëzet tridhjetë libra. U shërben lexuesve. Kushdo që ia kërkon një libër, që e di se është dashamirës i leximit, është në gjendje të bëjë rrugë njëqind kilometra dhe t'ia dërgojë librin në vend. Kjo është lumturia e tij. Edhe më i lumtur është kur gjen ndonjë libër të mirë dhe ia propozon dikujt për lexim. Edhe më i lumtur se kaq është kur ai që ia ka blerë (shpeshherë edhe ia huazon për lexim, nuk ia merr paratë), i flet për librin që ia ka sugjeruar për lexim. Ky është njeri fisnik. Një kësi njeriu i duhet Shoqatës së Botuesve të Kosovës. Jam përpjekur, kohë pas kohe, takim pas takimi me

të, të vjedh pak nga karakteri i tij. Duke marrë mësim nga kultura e punës së tij dhe shkas prej neverisë së disa autorëve dhe botuesve, në çdo edicion të panairit kam ndenjur shumë pak kohë te stenda ime. Ua kam lënë në dorë kuletën dhe librat miqve dhe mikeshave. Besim në ta, plot. Edhe jetën. Kam ndenjur dhe kam vëzhguar punën e botuesve nga kati i parë i pallatit si shqiponjë. Kam parë dhe kam ndier keqardhje se si botuesit dhe autorët e veprave ua zinin udhën vizitorëve dhe, për t'ua blerë një libër, edhe u përgjroheshin. Përpos vetveten, edhe vizitorët i bënin të ndiheshin keq që, ndoshta, mund të mos kishin para për t'ua blerë një libër e hequr qafe. Sa skena të rënda kam parë këto ditë. Sa dinjitet të përulur. Sa shpinë të kërrusura. E merrni me mend pse vepronin kështu autorët dhe botuesit?! Sepse, nëse s'e kanë paguar faturën për pjesëmarrje si unë para dhjetë ditësh, do ta paguajnë nëse duan të dalin gjallë nga aty. Punë e mundimshme, me të pritura e të papritura, me skena komike dhe tragjikomike, veprimtaria botuese ishte përplot. Ndoshta gjithmonë kështu ka qenë, por gjithmonë kështu nuk duhet të

mbesë. E unë botimet i bëj dhe i botoj për qejfin tim herë me shuma simbolike nga MKRS-ja, herë pa asnjë kacidhe nga askush. E kur më mohohet munda, sikurse kohën e fundit po ma mohon Këshilli i Librit i ministrit Çeku e po përpiqet t'i përkrahë botuesit e rinj, pronarët e tyre të moshës 20-25 vjet, që mezi i shkruajnë dy fjalë shqip, reagoj, sepse përpiqem ta mbroj dinjitetin e shkrimtarit dhe të botuesit. Kam marrë pjesë nëpër panairë për t'i nderuar autorët dhe librat e tyre, për t'ua paraqitur lexuesve botimet e reja, për të bashkëbiseduar e udhëtuar me ta nëpër pyje imagjinare e reale për autorët dhe për veprat e tyre. Natyrisht, edhe për ta përhapur sa më shumë emblemën e "Armagedoni"-t dhe veprimtarinë e tij botuese. Dhe, si gjithkund në botë, marketingu paguhet dhe, natyrisht, do të duhej edhe të shpaguej. Megjithatë, në Prishtinë, në vitin 2024, në panair të librit, nuk ndodhi kështu. Dhe kurgjë s'qe sivjet çka do të jetë në vitin e ardhshëm. Botuesit, vizitorët dhe librat e rinj do të pakësohen, kurse organizatorët do të vazhdojnë të mburren dhe të japin

plakate pa para, edhe pa i lexuar librat fare. Dhe, një ditë prej ditësh, siç s'po vijnë qytetarët e Shqipërisë në Panairin e Prishtinës, një ditë prej ditësh as ne nuk do të shkojmë në atë të Tiranës. I nderuari të nderon, e ai që s'të nderon, s'ia vlen të nderohet. Edhe ata autorë dhe ato shtëpi botuese, që në rrjete sociale paraqesin kopertina të reja të titujve të vjetër, kinse botimi i dytë, i tretë, një ditë do të harrohen. Maskat do t'u bien në pikë të ditës dhe në mesnatë. Dhe, u ranë. Puna e tyre u pa. E panë botuesit. E pa stafi i botuesve. E panë vizitorët. E transmetuan mediet te shikuesit dhe te dëgjuesit. Më pyetën shumë kolegë botues, shumë miq, shumë autorë, pak lexues, të cilëve ua përmenda gjatë këtyre pesë ditëve të panairit këto shkarje e të meta ndër vite të organizimit të Panairit të Librit në Prishtinë, sidomos të edicionit të fundit, se a është përgjegjëse vetëm Shoqata e Botuesve e Kosovës për këtë dështim apo kanë faj edhe të tjerët? Kush janë të tjerët, - i pyeta? Lexuesit... ne... institucionet... më thanë duke menduar e duke u shprehur me pauza. Të gjithë kemi faj nga pak, u thashë, por më së

paku ne botuesit që, për shkak të taksës dhe gjobës që na vë "shtëpia" jonë që merr para në emrin tonë e të librit nga institucionet dhe nga ne, nuk mund t'u ofrojmë zbritje më të madhe dashamirëve të librit dhe nuk mund t'i presim më mirë. Dhe atyre u premtova, se derisa ky panair të jetë me pagesë e derisa të bëhet pa pagesë, "Armagedoni" nuk do të marrë më pjesë. M'u duk sikur më thanë s'do të marrim më as ne. Unë do ta mbaj fjalën deri në një vendim tjetër të Shoqatës, ndërsa autorët dhe veprat e atyre që i kemi botuar dhe që do t'i botojmë, do të vazhdojmë t'i nderojmë, t'i vlerësojmë dhe t'i paraqesim në panairë të qyteteve të tjera dhe t'i shpërndajmë nëpër librari të Kosovës, të Shqipërisë e të Maqedonisë së Veriut. Gjithashtu, do të punojmë diçka speciale për ta dhe për veprat e tyre, të cilën, ndërkohë, do të mund ta marrin botuesit e tjerë shembullin prej nesh. Nëse keni ndonjë përgjigje tjetër për librin, ma jepni në këtë email: [shbarmagedoni@gmail.com](mailto:shbarmagedoni@gmail.com). Shëndet! Dhe, pushime të mbara!

**Autori është botues**



# Zbarkimi që solli mposhtjen e Gjermanisë naziste



U bënë 80 vjet nga Dita-D [D-Day] – dita e parë e zbarkimit në Normandi, që hodhi bazën e aleatëve për mundjen e Gjermanisë naziste në Luftën e Dytë Botërore. Pushtimi – i koduar si Operacioni Mbizotëruesi [Operation Overlord] – kishte dhjetëra-mijëra trupa nga vende të ndryshme, duke përfshirë Shtetet e Bashkuara, Mbretërinë e Bashkuar dhe Kanadanë, të cilët zbarkuan në pesë vende të vijës bregdetare të Normandisë në Francë – të koduara si plazhet Juta, Omaha, Ar [Gold], Juno dhe Shpata [Sword]. Planifikimi për Ditën-D filloi më shumë se një vit më parë dhe aleatët bënë mashtrime të konsiderueshme ushtarake për të ngatërruar gjermanët se kur dhe ku do të ndodhte pushtimi.

Nga: Catherine NICHOLLS / CNN  
Përkthimi: Telegrafi.com

## Kur ishte Dita-D?

Fillimisht, operacioni planifikohej të niste më 5 qershor 1944, kur hëna e plotë dhe baticat e ulëta pritëshin të përkonin me motin e mirë, por stuhitë e imponuan vonesën 24-orëshe. Divizionet aleate filluan të zbarkojnë në pesë plazhe në orën 6:30 të mëngjesit të 6 qershorit.

## Çfarë do të thotë Dita-D?

Termi Dita-D ishte kod ushtarak për fillimin e një operacioni të rëndësishëm, ku “D”-ja e parë ishte shkurtesa për “Ditë” [Day]. Kjo do të thotë se Dita-D në të vërtetë është “Dita-Dita”.

Sipas Legjionit Mbretëror Britanik, fraza Dita-D përdorej mjaft shpesh përpara pushtimit të Aleatëve në

qershor 1944. Megjithatë, tani Dita-D zakonisht kuptohet se i referohet fillimit të Operacionit Mbizotëruesi.

## Cilat vende aleate ishin të përfshira?

Dita-D nënkupton bashkëpunimin e paprecedentë midis forcave të armatosura ndërkombëtare, me më shumë se dy milionë trupa në Mbretërinë e Bashkuar në përgatitjet për pushtimin – kjo sipas të dhënave të Muzeut të Luftës Imperiale (IWM).

Shumica e këtyre trupave ishin amerikane, britanike dhe kanadeze, raporton IWM, por trupat erdhën gjithashtu nga Australia, Belgjika, Republika Çeke, Franca, Greqia, Holanda, Zelanda e Re, Norvegjia, Rodezia (tani Zimbabve) dhe Polonia për të marrë pjesë në Operacionin Mbizotëruesi.

## Çfarë përgatitjesh u bënë?

Invadimi i trupave aleate u koordinua në ajër, tokë dhe det, në atë që mund të përshkruhet si zbarkim amfib.

Këto u paraprinë nga një fushatë e gjerë bombardimi, për të dëmtuar mbrojtjen gjermane, si dhe me përdorimin e taktikave të mashtrimit.

Operacioni Truproja [Bodyguard] ishte term për strategjinë e mashtrimit që çoi në pushtimin e aleatëve në Evropë në qershor 1944. Operacioni Qëndresa [Fortitude] ishte taktikë nën këtë ombrellë, që në mënyrë specifike ndërli dhe kishte për qëllim ta bënte Gjermaninë naziste të besonte se sulmet fillestare në Normandi ishin thjesht devijim dhe se pushtimi i vërtetë do të ndodhte diku tjetër.

Sipas IWM-së, Qëndresa Veri [Fortitude North] synonte të mashtronte gjermanët që të besonin se aleatët do të sulmonin Norvegjinë, ndërsa Qëndresa Jug [Fortitude South] u krijua për të bindur gjermanët se aleatët do të zbarkonin në Pa-de-Kale, një hapësirë franceze në verilindje të Normandisë që është më afër Mbretërisë së Bashkuar.

## Çfarë ndodhi në Ditën-D?

Trupat amerikane u caktuan në plazhin e Jutës në bazën e Gadishullit Kotentin dhe në plazhin Omaha në skajin verior të bregut të Normandisë. Britanikët zbarkuan më pas në plazhin e Artë, ndjekur nga kanadezët në Juno, dhe më në fund britanikët te Shpata – te pika më lindore e pushtimit.

Nga mesnata, trupat kishin siguruar pozicionet në plazhe dhe u zhvendosën më tej në brendësi nga Juta, Ar, Juno dhe Shpata [emra të koduar].

Megjithatë, jo të gjitha zbarkimet ishin të suksesshme; forcat amerikane pësuan humbje të konsiderueshme në Omaha, ku rrymat e forta detyruan shumë anije të zbarkimeve të largoheshin nga pozicionet e synuara, duke vonuar dhe penguar strategjinë e pushtimit.

Zjarri i rëndë nga pozicionet gjermane në shkëmbinj të thepisur, të cilët nuk ishin

shkatërruar si duhet nga bombardimet aleate përpara pushtimit, shkakuan gjithashtu viktima.

## Si u munduan gjermanët të mbroheshin?

Sipas IWM-së, reagimi i Gjermanisë ndaj Operacionit Mbizotëruesi ishte “i ngadaltë dhe konfuz”.

Moti më 6 qershor ishin ende e keq, shumë komandantë të lartë nuk ishin në postet e veta, dhe Operacioni Qëndresa e bindi Adolf Hitlerin se pushtimi i Normandisë ishte rrenë përpara një sulmi më të madh në Pa-de-Kale.

Forcat ajrore të Gjermanisë ishin në veprim diku tjetër, duke u mbrojtur nga operacionet e bombardimeve amerikane mbi Gjermani. Anijet e saj të marinës u ankoruan në porte ose u shkatërruan nga aleatët. Sipas IWM-së, kjo la vetëm ushtrinë gjermane për t’u mbrojtur kundër Operacionit Mbizotëruesi.

Për më tepër, suksesi i Operacionit Qëndresa nënkuptonte se shumë njësi të ushtrisë u mbajtën larg fushëbetesës së Normandisë, deri në korrik, pasi ende pritej një sulm në Pa-de-Kale.

Trupat gjermane të mbrojtjes bregdetare “bënë aq sa mund të pritej”, thotë nga IWM, përpara se përfundimisht të “heshten” dhe njësitë aleate të përparonin në brendësi.



### Sa njerëz vdiqën në Ditën-D?

Vetëm në Ditën-D, rreth 4 440 trupa aleate u konfirmuan të vdekur – sipas Komisionit të Varrezave të Luftës së Komonueltit (CWGC), me më shumë se 5 800 trupa të plagosur ose të humbur. Për shkak se plazhi Omaha ishte plazhi më i përgjakshëm, ushtria amerikane humbi shumicën e njerëzve në zbarkimet amfibe. Rreth 2 500 trupa amerikane vdiqën në sulmet në plazh dhe në operacionet e Ditës-D – sipas CWGC-së.

Numri i saktë i viktimave gjermane atë ditë nuk dihet, por ato vlerësohen të jenë midis 4 000 dhe 9 000.

Kush ishin djemtë e Bedfordit?

Nga dhjetëra mijëra trupat që

sulmuan plazhet e Normandisë në Ditën-D, 44 ishin ushtarë, marinarë dhe aviatorë nga Bedfordi i Virxhinias në ShBA.

Brenda pak minutave pasi arritën në plazhin Omaha, 16 nga këta burra u vranë dhe katër u plagosën. Një tjetër ushtar i Bedfordit u vra diku tjetër në Omaha, dhe tre të tjerë supozohet se u vranë në aksion – duke e çuar shifrën e vdekjes së Bedfordit në Ditën-D në 20 burra.

Sipas Fondacionit Kombëtar të Përkujtimit të Ditës-D, Bedfordi pësoi humbjen më të lartë për frymë në ShBA në Ditën-D.

### Çfarë ndodhi pas Ditës-D?

Pavarësisht sigurimit të një baze në brigjet franceze në Ditën-D, forcat aleate u përballën me rrezikun

nëse bombardimet gjermane mund t'i shtynin përsëri në det.

Ata duhej të shtonin numrin e trupave dhe pajisjet në Normandi, më shpejt sesa gjermanët, duke mundësuar invadimin e vazhdueshëm në kontinentin e Evropës.

Aleatët përdorën fuqinë ajrore për të ngadalësuar përparimin gjerman drejt Normandisë, duke hedhur në erë urat, hekurudhat dhe rrugët në të gjithë rajonin. Kjo i lejoi aleatët të fitonin kontrollin total të Normandisë dhe të lëviznin drejt Parisit të cilin e çliruan në gusht 1944.

### Çfarë ndikimi pat ky operacion në luftë?

Departamenti Amerikan i Mbrojtjes e quan Ditën-D si “fillimi

i suksesshëm i fundit të regjimit tiranik të Hitlerit”. IWM e quan “fitoren më domethënëse të Aleatëve perëndimorë në Luftën e Dytë Botërore”.

Duke futur forcat në Normandi, aleatët ishin në gjendje të fillonin përparimin e tyre në Evropën veriperëndimore. Megjithëse Lufta e Dytë Botërore zgjati gati edhe një vit tjetër në Evropë, sukcesi i Operacionit Mbizotëruesi çoi në çlirimin e Francës dhe lejoi aleatët të luftonin kundër gjermanëve në Evropën e pushtuar nga nazistët. Muzeu Kombëtar i Luftës së Dytë Botërore të ShBA-së thotë se mënyra më e mirë për të vlerësuar rëndësinë e Ditën-D është të imagjinosh se çfarë do të kishte ndodhur nëse operacioni do të kishte dështuar. Sipas muzeut,


zbarkimi nuk do të ishte e mundur për të paktën një vit.

Gjatë asaj kohe, Hitleri do të mund të kishte forcuar mbrojtjen bregdetare të Evropës së pushtuar nga nazistët, të zhvillonte aeroplanët dhe armët, të bombardonte Mbretërinë e Bashkuar edhe më rëndë dhe të vazhdonte fushatën e vrasjes, thotë nga Muzeu.

Luftimet nga aleatët në frontin perëndimor dhe ushtarët rusë në frontin lindor, përfundimisht çuan në humbjen e forcave naziste gjermane.

Më 7 maj 1945, Rajhu i Tretë Gjerman nënshkroi dorëzim të pakushtëzuar në Reims të Francës. Dita e Fitores në Evropë (V-E) festohet të nesërmen, pasi armëpushimi hyn në fuqi. /Telegrafi/





Veton ZYMBERI, redaktor i sportit

## Cavalli, trajneri i ri i Prishtinës

**PRISHTINË, 9 QERSHOR** - FC Prishtina të dielën përmes një komunikate zyrtare në rrjetet sociale ka njoftuar se ka arritur marrëveshje me trajnerin francez Jean-

Michel Cavalli. Cavalli do t'i prijë ekipit nga kryeqyteti në sezonin 2024/2025, ndërsa ka një karrierë të pasur pasi ka drejtuar klube të ndryshme brenda dhe

jashtë Francës. "FC Prishtina dhe kryetrajneri, Jean-Michel Cavalli kanë arritur akordin për t'i prirë skuadrës në edicionin 2024/25. Francezi 64-vjeçar

i lindur në Korsikë të Francës, ish-futbollist për shumë vite i korsikanëve të GFC Ajaccio, ka karrierë të rryer prej trajneri", thuhet në njoftimin e Prishtinës.



# Legjenda Fadil Vokrri kujtohet në 6-vjetorin e shkuarjes në amshim

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 9 QERSHOR** - Legjenda e futbollit të Kosovës dhe ish-kryetari i Federatës së futbollit të Kosovës, Fadil Vokrri është kujtuar e nderuar në 6 vjetorin e shkuarjes në amshim. Figura e ish 9-shit të artë në skuadrën e Prishtinës është vlerësuar lartë, derisa edhe kontributin i tij në ndërkombëtarizimin e futbollit të Kosovës. Kryetari aktual i FFK-së dhe bashkëpunëtori i ngushtë i Vokrrit, Agim Ademi ka thënë se 9 qershori i vitit 2018 mbetet datë që sjellë ndjesi nostalgjke, por edhe krenarie për trashëgiminë e pasur që Vokrri la te të gjithë ata që e adhuruan, por edhe patën fatin ta njihin nga afër dhe të punojnë me të. "Fadil Vokrri ishte një futbollist i jashtëzakonshëm dhe i përmasave botërore. Talentin që

ia dhuroi Perëndia, ai e shndërroi në pasion dhe dashuri të pakufishme për lojën magjike të futbollit. Me aftësitë e tij të shkëlqyeshme me topin, intuitën për gol dhe stilin unik, Vokrri u shqua që në rininë e tij të hershme. Me paraqitjet në fanellën e Prishtinës, ai bëri që një popull i tërë ta thërriste emrin e tij dhe tek ai të shihte shpresën e gëzimit. Karriera e tij e ndritur, brenda dhe jashtë vendit, e bëri atë një nga figurat më të dashura dhe të respektuara në historinë e sportit tonë. Përtej talentit në fushë, Fadili ishte njeri me zemër të madhe dhe mendjemprenhtë, teksa disa vjet pas çlirimit të vendit vendosi që të kthehej në vendlindje dhe të kontribuonte në udhëheqjen e klubit të tij të zemrës, e më pas edhe të Federatës. Ardha e tij ishte shpresë, teksa misioni i përbashkët ishte anëtarësimi në UEFA e FIFA.



Ndonëse ky rrugëtim nuk ishte i lehtë, autoriteti dhe këmbëngulësia e tij, por edhe i të gjithë atyre që ishim pjesë e Federatës, si dhe mbështetja e institucioneve vendore dhe faktorëve ndërkombëtarë, bëri që ky mision të përmbylej suksesshëm në maj të vitit 2016.

Fadil Vokrri ishte simbol uniteti për futbollin, derisa trashëgimia që la pas është një thesar i paçmuar. Teksa nderojmë Legjendën tonë, ne i jemi mirënjohës për gjithçka që bëri për futbollin në Kosovë. Të frymëzuar nga trashëgimia e tij do të vazhdojmë të punojmë me

përkushtim për një të ardhme të ndritur për brezat e rinj, me besim të plotë se vendi ynë do të japë edhe shumë talente si ai. I përjetshëm kujtimi për TY, Legjendë!", ka thënë Ademi, i cili bashkë me Komitetin Ekzekutiv të FFK-së dhe bashkëpunëtorë kanë bërë homazhe te varri i legjendës, Fadil Vokrri. Legjendën Fadil Vokrri e ka kujtuar edhe ministri i Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Hajrullah Çeku. "Gjashtë vite në kujtim të legjendës së futbollit, Fadil Vokrri! Përjetësisht falënderues ndaj veprës dhe angazhimit të tij për zhvillimin e futbollit. Kujtimi dhe nderimi për të është i përhershëm, ndërsa vepra e tij është frymëzim për punën tonë sot", ka shkruar ministri i sportit. Vokrri është kujtuar edhe nga ish-klubet e tij, sportistë, politikanë dhe qytetarë të shumtë.

## Barcelona fiton titullin e Ligës së Kampionëve në hendboll

**BARCELONË, 9 QERSHOR** - Hendbollistët e Barcelonës mposhtën Aalborgun e Danimarkës me rezultat 31:30 në finalen e Ligës së Kampionëve dhe kështu fituan titullin e kampionit të Evropës për klube. Katalanasit kaluan në finalen e Ligës së Kampionëve në hendboll duke mposhtur Kielin, ndërsa lojtarët e Aalborg mundën Magdeburgun. Para mijëra tifozëve të saj në Kohn, Barcelona fitoi pas një drame të vërtetë, e cila garantoi emocione për të gjithë shikuesit nga minuta e parë deri në minutën e fundit.



Pjesa përfundoi me rezultatin 15:15 dhe Barcelona e bëri diferencën e parë të dukshme pesë minuta para fundit kur shkoi në plus tre. Danezët arritën të bëjnë një seri të mirë dhe të sjellin pasiguri në duel, por në fund

Barcelona arriti të mbrohej në një sulm në të cilin Aalborg pati një shans për të barazuar dhe për të shkuar në kohën shtesë. Francezët ishin më efikasë te Barcelona dhe sollën fitoren sot, përkatësisht Melvin Richardson me tetë gola, Dika Mem me shtatë gola dhe Timothy N'Guessan me gjashtë gola. Te Aalborg, Mikkel Hansen shënoi tetë gola. Është trofeu i 12-të i Barcelonës në Ligën e Kampionëve, që e bën gjigantin katalanas rekordmen në garë. Nga ana tjetër, Aalborg do të jetë ende në pritje të trofeut të parë.

## Ramadani, Italisë: Hyjmë në fushë për të marrë pikë

**Tiranë, 9 qershor** - Shqipëria ka mbërritur në tokën gjermane, atje ku edhe do të zhvillojë 3 ndeshjet e Grupit B të Kampionatit Evropian Para ndeshjeve, ka folur futbollisti Ylber Ramadani, i cili thotë se Kombëtarja shqiptare ka një objektiv të qartë në këtë kompeticion, dhe ai është që të marrim maksimumin në çdo ndeshje dhe të kalojmë grupin. Derisa, thekson se në ndeshjen ndaj



Italisë hyjmë për pikë, duke shtuar se gjithmonë i ka pëlqyer kur nuk i kanë vlerësuar, sepse sipas tij kjo të jep motivim dhe në heshtje mund t'i fitosh të gjithë. "Takimi me Italinë është në ndeshje shumë e veçantë sepse luajmë kundër kampionëve në fuqi. Duhet të hyjmë në fushë dhe të marrim pikë dhe jo vetëm të themi që kemi luajtur mirë", është shprehur Ramadani.

## Nuhiu emërohet trajner i Gjilanit

**Gjilan, 9 qershor** - SC Gjilani ka filluar rindërtimin për sezonin e ri, pas problemeve që kaloi sezonin e kaluar. Tashmë të stabilizuar në çdo aspekt, Gjilani ka nisur të zyrtarizojë ndryshimet në klub. Duke nisur

nga drejtori Sportiv, Ertan Demiri, klubi gjilanas para pak minutash ka zyrtarizuar edhe trajnerin e ri. Ish-trajneri i Dritës, Ardian Nuhiu do të jetë në krye të shtabit teknik, i cili rikthehet në futbollin kosovar,

pas një përvoje jo të mirë te Shkëndija sezonin e kaluar. Ardian Nuhiu e njeher mirë edhe qytetin e Gjilanit, pasi më herët kishte qenë trajner te Drita, nga shkurti i vitit 2019, deri në gjysmën e parë të sezonin

2022/23. Nuhiu madje edhe e ka të fituar një titull të Superligës, atë në sezonin 2019/20. Gjilani sezonin e kaluar përfundoi në vendin e gjashtë në tabelë, duke i ikur barazhit tek në javën e fundit të kampionatit.



Sot u bë një vit nga vdekja e më të dashures tonë



## Marije (Laska) Kqira

(20.05.1931-10.06.2023)

Vitet kalojnë, por nuk e shuajnë mallin, kujtimin, dashurinë dhe respektin për ty.

Mungesa jote është zbrazëti që nuk plotësohet kurrë.

Ishe dhe do të mbetesh Nënë dhe Gjyshe e dashur për të gjithë ne!

**Do të ju kujtojnë gjithmonë me mall, dashuri e krenari: Djemtë, vajzat, rejat, nipat, mbesat dhe mbarë familja Kqira nga Zhubi.**



**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992

